

28 shkurt 2013, Prizren

DEKLARATË

E organizatave të Rrjetit të Organizatave të Kulturës në Prizren në lidhje me përfshirjen e shoqërisë civile në Këshillin e Trashëgimisë Kulturore të Qendrës Historike të Prizrenit

Ne organizatat e poshtë nënshkruara të shoqërisë civile, aktive në fushën e kulturës dhe trashëgimisë kulturore në Prizren, shprehim qëndrimin tonë lidhur me përfshirjen në organin e paraparë në Ligjin për Qendrën Historike të Prizrenit, në të cilin kërkohet që organizatat e shoqërisë civile të jenë pjesë e Këshillit të Trashëgimisë Kulturore të Qendrës Historike të Prizrenit.

Lidhur me zbatimin e ligjit për qendrën historike të Prizrenit, është filluar të kërkohet përfshirja e ndonjërisë nga organizatat prizrenase të shoqërisë civile në një “Këshillin e Trashëgimisë Kulturore”, i paraparë në përbërje prej përfaqësuesve të bashkësive fetare dhe pjesëtarëve të shoqërisë civile. Ky Këshill ushtron funksion publik, që rezulton në fund me rol vendimmarrës të bashkësive fetare në marrjen e vendimeve të ndryshme që rregullojnë dhe organizojnë jetën e qytetarëve në qendrën e qytetit.

Rrjeti i organizatave të kulturës në Prizrenit (RrOK) konsideron se ky veprim bie ndesh me Kushtetutën e Kosovës, e cila shprehimisht ndalon që autoritetet fetare të ushtrorë kompetencë publike. Qëndrimi i organizatave të shoqërisë civile, pjesë e RrOK Prizren, tashmë është i njohur. Për më tepër se tre vjet ato kanë organizuar aktivitete të ndryshme, filluar nga tryezat e diskutimit, paraqitjet mediale, reagimet me shkrim, ndërgjegjësimet e qytetarëve dhe të deputetëve, organizimi i demonstratës, peticionit me mbi 10.000 nënshkrime, ankesës në Gjykatë Kushtetuese etj. Të gjitha këto aktivitete kanë mobilizuar një shoqëri të tërë, përfshirë komunitetin e biznesit dhe partitë politike si në pozitë ashtu edhe në opozitë, që të ketë një qëndrim të harmonizuar kundër përmbajtjes së këtij ligji, i hartuar pa asnjë përfshirje të qytetarëve prizrenas dhe i konsideruar tejet i dëmshëm për qytetin e Prizrenit dhe për shtetin e Kosovës, pasi që krijon bazë për konflikte të ardhshme mes komuniteteve të Prizrenit dhe në Kosovë, dhe ngulfat potencialin zhvillimor të qytetit dhe të vendit.

Megjithatë, asnjë nga gjitha këto nuk është marrë parasysh, dhe Ligji për Qendrën Historike të Prizrenit, nga trysnia e madhe politike ndërkombëtare dhe disa politikanë kosovarë, është miratuar në Kuvendin e Kosovës. Lidhur me ftesën e Kuvendit të Komunës së Prizrenit për përfshirjen e pjesëtarëve të shoqërisë civile në Këshillin e Trashëgimisë Kulturore, Rrjeti i Organizatave të Kulturës në Prizren (RrOK) merr qëndrim që në asnjë rast, asnjë nga organizatat që përfaqësojnë këtë Rrjet nuk përfshihen në krijimin dhe marrjen pjesë në këtë Këshill, dhe si pjesë e shoqërisë civile i mbetet besnik qëndrimit tashmë të njohur. Gjithashtu RrOK bën thirrje të gjithë pjesëtarëve tjerë të shoqërisë civile të distancohen nga përfshirja në angazhimet kundër kushtetuese.

Rrjeti i Organizatave të Kulturës në Prizren (anëtarët)

EC Ma Ndryshe, Dokufest, Fondacioni për TK Legatum, Forumi për Trashëgimi Kulturore, ATTA, N’GO, GreenArt, X40, Ura e Artit, Durmish Asllano, ICEC, Old Timer Club Prizren, ShB Sharri, Leo’s Art Organization, Xhennet Comics, SHKA Agimi, SHKA Malësori, SHKA Dogru Yol, SHKA Lidhja e Prizrenit, ShNsh Demastion, Pentagram, EUIRC